

---


# Analizë e Rregullës për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të Energjisë me Shumicë

---

ANALIZË E POLITIKAVE

---

02/2020



# Analizë e Rregullës për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të Energjisë me Shumicë

---

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Mars, 2020**

Foto e ballinës: **Unsplash**



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

## Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**National Endowment  
for Democracy**  
*Supporting freedom around the world*

Ky punim është publikuar me mbështetjen e National Endowment for Democracy. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

## **Përmbajtja**

Hyrje .....	2
Komente të përgjithshme .....	2
Komente dhe rekomandime specifike .....	3
Përfundime.....	6

## **Hyrje**

Kjo analizë me komente është pjesë e programit të Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) për zhvillimin e qëndrueshëm dhe programit të qeverisjes demokratike. INDEP ka analizuar Rregullën e vendosur në konsultim publik nga ana e Zyrës së Rregullatorit për Energji duke u ndjekur nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së interesit publik.

Ne si INDEP kemi kërkuar dhe vazhdojmë të insistojmë që konsultimi publik i organizuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) të bëhet sipas standardeve më të mira të konsultimit paraprak dhe përgjatë vendimmarrjes siç janë ato të përcaktuara në Rregulloren Qeveritare për Standardet Minimale për Konsultimin Publik të Qeverisë së Kosovës.

Komentet janë të ndara në dy pjesë kryesore: komente të përgjithshme dhe komente specifike. Në pjesën e komenteve të përgjithshme, ne kemi bërë një vlerësim të përgjithshëm mbi nismën si të tillë, qasjen e përgjithshme dhe rekomandimet e përgjithshme që i kemi rreth kësaj Rregulle. Në pjesën e komenteve specifike, ne kemi identifikuar dhe shpjeguar nene të caktuara të Rregullës për të cilat kemi vërejtje.

## **Komente të përgjithshme**

Në një treg të energjisë që gjithnjë e më shumë po hapet, Rregulla për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të Energjisë me Shumicë është një dokument i rëndësishëm për sigurimin e ruajtjes së konkurrencës së lirë në treg dhe parandalimin e praktikave manipuluese. Po të modifikohet gjuha dhe të sigurohet një precizitet dhe thjeshtësim më i madh, Rregulla ka potencial të jetë një dokument i frytshëm dhe plotësues për bazën aktuale ligjore.

Drafti i Rregullës është shkruar me gjuhë të pakuptimt, me elemente të përsëritura dhe të panevojshme dhe formulime që krijojnë konfuzion dhe lënë hapësirë për interpretim. Nene të caktuara të kësaj Rregulloreje mund të interpretohen jo për të mbrojtur transparencën dhe integritetin e tregut, por përkundrazi, për të heshtur informata të cilat mund të jenë në dobi të interesit publik.

## **Komente dhe rekomandime specifike**

### **1. Fillimisht, në Nenin 1 – Qëllimi dhe Fushëveprimi, në paragrafin 5 thuhet:**

ZRRE dhe, aty ku është e përshtatshme, autoritetet kombëtare të konkurrencës dhe autoritetet e tjera relevante kombëtare bashkëpunojnë për të siguruar që një qasje e koordinuar është marrë për zbatimin e kësaj rregulle, ku veprimet ndërlidhen për një ose më shumë produkte të energjisë me shumicë, në të cilat zbatohen Nenet 3, 4 dhe 5 të kësaj Rregulle.

Ne propozojmë të hiqet shprehja “aty ku është e përshtatshme”. Bashkëpunimi i ZRRE-së me Autoritetin e Konkurrencës është obligativ në bazë të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës:

Me kërkesë të Autoritetit, sipas nenit 38 të këtij ligji, të gjitha organet e administratës publike dhe organet lokale, si dhe personat juridik, janë të detyruar që Autoritetit, t’i dorëzojnë të gjitha informacionet, dokumentacionin e kërkuar, duke përfshirë edhe të dhënat dhe dokumentet që përmbajnë sekrete afariste, ndërsa Autoriteti me të dhënat dhe dokumentet e tilla është i detyruar të veprojë në pajtim me dispozitat e nenit 50 të këtij ligji.<sup>1</sup>

Përveç kësaj, vet shprehja “aty ku është e përshtatshme” nuk është gjuhë legislative e përshtatshme pasi krijon dilema se kush dhe kur konstatohet se është e përshtatshme dhe kur jo. Për këtë, ne kërkojmë që kjo shprehje të hiqet tërësisht nga ky nen apo edhe i tërë paragrafi pasi bashkëpunimi është i nënkuptueshëm dhe i obligueshëm me Ligj.

**Në nenin 2 – Përkufizimet dhe Interpretimet i kemi gjetjet në vijim:**

#### Përkufizime të panevojshme:

1.2. Dokument

1.11. Sektori i energjisë

1.12. Treg i energjisë me shumicë

1.13. Pjesëmarrës i tregut

1.14. Person

1.15. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE)

1.16. Autoritet Publik

1.17. Operator i Sistemit të Transmetimit

1.18. Ndërmarrje

---

<sup>1</sup> Republika e Kosov[s], (2010), Ligji Nr. 03/L-229 p[r Mbrojtjen e Konkurrenc[s], Neni 61, Bashkëpunimi i Autoritetit me Organet Gjyqësore dhe Organet Tjera, faqe 29, Prishtin[: GZRKS.

Të gjitha këto përkufizime, për sektorin e energjisë janë dije e përgjithshme dhe përkufizimi për to është i panevojshëm dhe vetëm e ngarkon dokumentin. Për më tepër, këto përkufizime ekzistojnë në ligje të tjera respektive dhe Rregulla nuk ka nevojë t'i përmbaj.

Gjithashtu, 1.20 Operatori i Sistemit të Transmetimit të gazit natyror nuk ekziston në Kosovë dhe si i tillë ky definim duhet hequr.

### **Në nenin 3 – Ndalimi i tregimit nga personat e brendshëm**

Ne kërkojmë që të hiqet paragrafi 1 ku thuhet:

Kushdo që në mospajtim me detyrat e tij për të mbrojtur informatat e brendshme të cilat i mëson gjatë kryerjes së aktivitetit ekonomik ose sipas detyrës zyrtare, i kumton personit të paautorizuar informatën e panjohur për publikun dhe që mund të ndikoj në produkt me shumicë të energjisë ose kushdo që në ndonjë mënyrë tjetër përdor informatën e tillë për dobi personale ose për qëllim të avantazhit të padrejtë në tregun e energjisë me shumicë për ndonjë person fizik apo juridik e ka të ndaluar sipas kësaj Rregullore dhe Legjislacion penal në fuqi.

Ky përkufizim nuk ndodhet në Rregulloren 1227/2011 të Bashkimit Evropian dhe si i tillë krijon paqartësi. Paragrafi flet për detyrimin për të heshtur informatat e brendshme ndërkohë që ndodhet brenda Nenit që ekskluzivisht rregullon ndalimin e tregimit nga personat e brendshëm. Gjithashtu, është i paqartë sepse nuk është definuar çka nënkupton me person të paautorizuar tek i cili nuk lejohet plasimi i informatës. Për këto arsye, ne kërkojmë që ky paragraf të hiqet nga teksti i nenit.

### **Në nenin 6 – Monitorimi i tregut**

Në nenin 6, paragrafi 3 është thënë:

Palët Kontraktuese mund tu ofrojnë autoriteteve të tyre kombëtare të konkurrencës ose një organi të monitorimit të tregut të krijuar brenda atij autoriteti për të kryer monitorimin e tregut me ZRRE-në. Në kryerjen e monitorimit të tillë të tregut, autoriteti kombëtar i konkurrencës ose organi i monitorimit të tregut do të kenë të njëjtat të drejta dhe detyrime si ZRRE.

Ky definim është dhënë në Rregulloren 1227/2011 të Bashkimit Evropian dhe u është dhënë si udhëzim shteteve (palëve kontraktuese) në mënyrë që ato të konsiderojnë ofrimin e mundësisë që organe të caktuara të mbrojtjes së konkurrencës të kryejnë aktivitete të monitorimit brenda kornizës së organit rregullues (në këtë rast ZRRE-së). Kjo nuk do të thotë që duhet futur në Rregull tonë dhe ne kërkojmë që të hiqet pasi nuk është e qartë kush janë palët kontraktuese dhe kush mund të marrë një vendim të tillë.

### **Në nenin 7 – Regjistrimi i pjesëmarrësve të tregut**

Në nenin 7, paragrafi 1 është thënë:

Pjesëmarrësit e tregut që hyjnë në transaksione me produkte me shumicë të energjisë ose shprehin interesin për të hyrë në transaksione të tilla përmes

procedurave të tregtimit duhet të regjistrohen pranë ZRRE-së, **ku bëhet dorëzimi i produkteve të energjisë me shumicë**. Për qëllime të regjistrimit, ZRRE do të aplikojnë formatin e regjistrimit të hartuar nga Agjencia për Bashkëpunim të Rregullatorëve Evropian (ACER) sipas kësaj rregulle. Rregullatori do të publikoj në faqen elektronike formatin e regjistrimit.

Shprehja “ku bëhet dorëzimi i produkteve me shumicë” ne propozojmë të hiqet sepse si e tillë është e paqartë se për çfarë bëhet fjalë. Sipas këtij definimi, në ZRRE bëhet dorëzimi i produkteve të energjisë me shumicë!

Në nenin 7 ne gjithashtu propozojmë që në paragrafin ne propozojmë që paragrafit 3 ti shtohet edhe një fjali e fundit me këtë përmbajtje: **“Regjistri i pjesëmarrësve të tregut do të jetë publik dhe do të azhurnohet në baza të rregullta”**. Ky definim rritë transparencën në treg dhe është pozitiv marrë parasysh faktin që rritë transparencën dhe besueshmërinë në proces.

## **Neni 8 – Mbrojtja e të dhënave**

Dispozita që kjo Rregull nuk paragjykon detyrimet e ZRRE-së dhe palëve në treg nga zbatimi i legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale është krejtësisht e panevojshme. Meqë Kosova nuk është anëtare e Bashkimit Evropian, natyrisht që Rregullorja e EU-së nuk ka zbatim të drejtëpërdrejtë mbi legjislacionin vendor. Për këtë, është e kuptueshme që në hierarkinë e normave, Ligji Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale qëndron mbi çdo Rregull dhe rrjedhimisht, neni 8 është i pa nevojshëm.

## **Nenet 10 dhe 11 mungojnë ose është gabuar rënditja e neneve**

Në të gjithë tekstin e Rregullës ka probleme të theksuara gjuhësore. Dokumenti është përkthyer nga Rregullorja e BE-së dhe ka shprehje të cilat është dashur të përshtaten dhe jo të përkthehen bukalisht. Për shembull, në nenin 13, paragrafi 2, është thënë:

ZRRE dhe autoriteti kombëtar i konkurrencës **në një Palë Kontraktuese** mund të krijojnë forma të përshtatshme të bashkëpunimit për të siguruar hetime efektive dhe efikase dhe për të kontribuar në një qasje koherente dhe të qëndrueshme ndaj hetimeve, procedurave gjyqësore dhe zbatimit të kësaj Rregulloreje dhe ligjin përkatës financiar dhe të konkurrencës.

Shprehja “në një palë kontraktuese” është tekst i marrë nga Vendimi i Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë 2018/01/MC-EnC<sup>2</sup> por që ka qenë i shenjuar që do të duhej të përshtatej gjuhësisht dhe jo të vihej si i tillë. Në formën e tanishme, kjo shprehje “palë kontraktuese” është në 8 vende të ndryshme në dokument që ua prishë kuptimin neneve sepse

---

<sup>2</sup> Komuniteti i Energjisë, (2018), REGULATION (EU) 1227/2011 of 25 October 2011 on wholesale energy market integrity and transparency, e qasshme n[ [https://www.energy-community.org/dam/jcr:011d891f-6cef-4555-9e9a-53d88e54d4b1/Regulation\\_1227\\_2011\\_REMIT.pdf](https://www.energy-community.org/dam/jcr:011d891f-6cef-4555-9e9a-53d88e54d4b1/Regulation_1227_2011_REMIT.pdf). (qasur n[ mars, 2020)

nuk është adoptuar si duhet. Nëse këto përshtatje nuk bëhen, atëherë një pjesë e konsiderueshme e neneve humbin kuptimin e drejtë që duhet ta kenë.

### **Neni 15 – Zbatimi i ndalimeve ndaj abuzimit të tregut**

Ne propozojmë që Neni 15 të fshihet nga Rregulla. Kjo dispozitë nuk ndodhet në Rregulloren e adoptuar të BE-së. Më e rëndësishmja, ne konsiderojmë që neni 15 tejkalon kompetencat e ZRRE-së dhe si i tillë duhet hequr nga Rregulla. Masat hetimore ndaj abuzimit të tregut realizohen nën kornizën e Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nga Autoriteti i Konkurrencës. Hetimet për abuzimin e tregut nuk janë në domenin e kompetencave të ZRRE-së. ZRRE mund dhe duhet të mbështesë punën e organeve të tjera në këtë drejtim, por asesi të marrë rol udhëheqës dhe proaktiv në zhvillimin e hetimeve ndaj abuzimit të tregut kur për këtë ekzistojnë organe të specializuara.

### **Neni 19 – Faktorët lehtësues gjatë shqiptimit të masave administrative dhe gjobave**

Edhe kjo dispozitë, për ne është e pa nevojshme dhe propozojmë të largohet fare për shkak se faktorët lehtësues dhe rëndues të shqiptimit të gjobave tashmë janë të përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje dhe në çdo rrethanë, Ligji do të ketë përparësi ndaj principeve të përcaktuara në këtë Rregull. Arsyeja e dytë pse konsiderojmë që ky Nen duhet hequr është formulimi i tij. Si faktor lehtësues janë paraparë:

- 1.1. Personi fizik apo jurik është përpjekur që të parandaloj ose të pakësoj dëmin e shkatuar nga shkelja;
- 1.2. Shkallën e dëmit që i është bërë subjektit fizik apo juridik;
- 1.3. Sjelljet paraprake,
- 1.4. Gjendjen financiare etj.

Është jashtëzakonisht subjektive vendosja e këtyre kriterëve si sjelljet paraprake apo shkalla e dëmit apo gjendja financiare. Nuk ka një bazë objektive të matjes së tyre dhe çfarëdo vlerësimi do të jetë krejtësisht subjektiv. Gjithashtu, dispozita përfundon me “etj.,” që nuk është praktikë normative dhe rritë pafundësisht subjektivitetin e vlerësimit. Për këto arsye, ne konsiderojmë që ky nen duhet të hiqet.

## **Përfundime**

Rregulla për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të Energjisë me Shumicë transponon Rregulloren e BE-së, 1227/2011 të 25 tetorit 2011 të adoptuar me vendimin e Këshillit të Ministrave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë Nr. 2018/01/MC-EnC të vitit 2018. Si e tillë, ajo është e rëndësishme për të kompletuar një bazë ligjore tashmë obligative në zbatim të legjislacionit evropian.

Rregulla është hartuar me një gjuhë të pa përpunuar dhe me raste shihet që është një përkthim pothuaj bukfal i Rregullosës së BE-së 1227/2011. Për këtë, nevojitet një lekturim dhe përshtatje e



dispozitave me realitetin dhe rendin juridik në Kosovë. Shprehjet si “Palët kontraktuese” apo “autoritetet tjera” etj., duhen zëvendësuar sepse janë futur me incicion sikur të ishin hartuar për 28 vende të BE-së. Përveç kësaj, ka probleme të shumta gjuhësore dhe dizposita që kanë kuptim shumë më tepër në anglisht sesa në draftin e propozuar.

Që tek definimet dhe interpretimet, kemi parë që dokumenti është mbingarkuar me elemente që ose janë dije e përgjithshme ose rregullohen me ligje të tjera dhe janë të pa nevojshme për t'u futur. Për këtë, ne kemi propozuar një numër reduktimesh në tekst të cilat do ta thjeshtëzonin Rregullën dhe do t'a bënin më të kuptueshme. Të ngjashme kanë qenë edhe nenet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale dhe me shtrembërimet e tregut që tashmë rregullohen me akte ligjore.

Ne kemi vlerësuar që Regjistri i pjesëmarrësve të tregut duhet të jetë publik dhe transparenca e të dhënave të jetë e përcaktuar gjithashtu në këtë rregullore. Gjithashtu, duke qenë se Rregulla ka obliguar ZRRE-në të kryej hetime për dyshime të abuzimit të tregut dhe atë në mënyrë direkte, ne kemi konsideruar që ZRRE duhet t'i asistoj dhe të bashkërendoj aktivitetet me Autoritetin e Konkurrencës por jo të marr një rol proaktiv. Përfundimisht, ne kemi parë edhe dispozita që kanë të bëjnë me kriteret për lehtësimin e gjobave që kanë qenë të panovojshme, të paqarta dhe të pa defnuara.

Përfundimisht, i kërkojmë Zyrës së Rregullatorit për Energji që të marr parasysht vërejtjet tona në mënyrë që kur të miratohet, ky dokument i rëndësishëm t'i shërbej objektivit të përbashkët për një treg energjetik funksional, transparent dhe me integritet.

